

Vendim nr. 264 datë 21.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERGYS VALISI**, përfaqësuar nga avokat Ilir Dode, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-369, datë 28.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 7, 42, 43, 131, pika 1 shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr.8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2007 kërkuesi ka filluar punë pranë shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k., në detyrën e mekanikut, në servisën e automjeteve. Marrëdhënia e punësimit është rregulluar me

kontratën individuale të punësimit në përmbajtje të së cilës janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes palëve.

2. Në datën 23.01.2014 kërkuesi është njoftuar nga pala e paditur, e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe se takimi me punëdhënësin do të bëhej në datën 27.01.2014 për të biseduar dhe diskutuar për kontratën e punës.

3. Në datën e njoftuar, më 27.01.2014, është zhvilluar takimi midis kërkuetit dhe palës së paditur, shoqëria “Porsche Albania” sh.p.k., gjatë të cilit ai është njohur me arsyet e marrjes së vendimit, si dhe ka dhënë shpjegimet e tij për punën e kryer që është përpjekur ta realizojë me cilësi.

4. Me shkresën e datës 30.01.2014 është zgjidhur kontrata e punës me kërkuetin. Në përmbajtje të kësaj shkrese janë cituar shkaqet e përfundimtare të zgjidhjes së kontratës, si dhe të drejtat e punëmarrësit për të përfituar shprehimisht: *“Bazuar në nenin 145 të Kodit të Punës shpërblimin për vjetërsi i cili është sa paga e një 15-ditëshi për çdo vit pune. Bazuar në nenin 143, pika 2, të Kodit të Punës, si dhe në pikën 1 e) të Kontratës së Punës së lidhur më 12.03.2007 marrëdhëniet tuaja dhe ato financiare ndërpriten pas një muaji, duke filluar nga dita e sotme (30.01.2014 - 28.02.2014).”*. Referuar librezës së punës, marrëdhëniet financiare mes kërkuetit dhe palës së paditur, “Porsche Albania” sh.p.k., janë ndërprerë më 01.03.2014.

5. Duke mos qenë dakord me largimin nga detyra, kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë për dëmshpërblimin nga zgjidhja e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara dhe në shkelje të afatit të njoftimit.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9942, datë 16.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës mes palëve ndërgjyqëse është bërë në kushtet e një zgjidhjeje të rregullt, duke u respektuar afati i njoftimit, zgjidhje e cila është në përputhje me parashikimet e nenit 141 i Kodit të Punës që përcakton shprehimisht se: *“Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati njoftimit.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 747, datë 05.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me të njëjtin arsyetim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas gjykatës, shkaqet e paraqitura në ankim nga kërkuesi nuk e cenojnë vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2025-369, datë 28.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke arsyetuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC),

sipas formulimit që ka pasur në kohën e paraqitjes së rekursit, pasi nuk rezulton që në gjykim të jenë lejuar shkelje procedurale që do të bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave. Gjithashtu, konstatohet se gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin procedural, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 24.06.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi në asnjë shkallë të gjyimit atij nuk i është dhënë përgjigje për faktin se shkresa e largimit nga puna është nënshkruar nga eprori i tij në punë dhe se dorëzimi i menjëhershëm i punës me urdhër të këtij eprori vërteton largimin e menjëhershëm të tij nga puna. Gjykatat e faktit nuk kanë marrë fare në shqyrtim themelin e pretendimeve të kërkuetit, duke analizuar vetëm formën dhe ekstremitetet e shkresës së datës 10.01.2014 që e njofton atë të largohet menjëherë nga puna pa asnjë shkak të ligjshëm dhe të drejtë. Ato gjykata nuk kanë verifikuar dhe përcaktuar faktet që qëndronin në themel të mosmarrëveshjes për largimin nga puna të kërkuetit. Ky interpretim i ngushtë që i kanë bërë ligjit gjykatat e faktit i kanë cenuar kërkuetit të drejtën për të pasur një procedurë të drejtë për largimin nga puna dhe garantimin e së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime për shkeljet ose arsyet që kishin shërbyer për largimin e tij nga puna. Gjykata e Lartë duhet të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkuetit që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykatat e faktit i mohonte atij të drejtën e punës për sa u takon detyrimeve pozitive të punëdhënësit. Mospranimi i rekursit nga kjo gjykatë, duke u mjaftuar vetëm në shqyrtimin *de plano* të çështjes, pa u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të kërkuetit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në verifikim të plotësisë të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe si bartës i të drejtave të pretenduara të cenuara ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuuesi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor dhe për të cilin ai nuk ka më mjete të tjera efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtat e tyre, ndaj ai e plotëson këtë kriter.

14. Kërkuuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që mban datën 10.12.2024, i cili i është komunikuar kërkuessit nëpërmjet *e-mail*-it në datën 26.02.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 24.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohet në vijim.

16. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë

funkionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 18, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë i ka analizuar pretendimet e kërkuesit dhe ka arritur në përfundimin se pala e paditur i ka respektuar të gjitha kriteret ligjore për kryerjen e procedurës sipas nenit 144 të Kodit të Punës. Shkresa e datës 10.01.2014 që kërkuesi pretendon se përbën shkresën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, është një shkresë absolutisht e pavlefshme. Drejtuesi i servisit nuk rezulton të jetë përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe shkresa në fjalë nuk përmban asnjë ekstremitet të shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k., si e tillë është një shkresë që nuk sjell asnjë lloj efekti për zbatimin e kontratës së punës mes palëve ndërgjyqëse, prandaj nuk mund të merret në konsideratë as nga kërkuesi, ashtu siç nuk është marrë në konsideratë nga pala e paditur. Në vijim, ajo gjykatë ka shqyrtuar edhe pretendimet për pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës dhe, duke iu referuar kontratës së punës midis kërkuesit dhe shoqërisë “Porsche Albania” sh.p.k., ka vlerësuar se nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme, por është një zgjidhje e rregullt, pra me afat njoftimi. Pala e paditur ka marrë vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës më 30.01.2014, ndërkohë që marrëdhëniet financiare rezultojnë të kenë përfunduar në datën 01.03.2014, pra në përfundim të afatit të

njoftimit. Po sipas gjykatës, referuar nenit 1, pika “e”, në Kontratën e Punës, palët kanë parashikuar shprehimisht se afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës do të jetë ai njëmujoj, përcaktim i cili është në përputhje me nenin 143, paragrafi 2, të Kodit të Punës, sipas të cilit: “*Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje me shkrim ose në kontratën kolektive të punës.*”. Mbi bazën e kësaj analize, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se padia e kërkuarit duhej rrëzuar. Ndërsa gjykata e apelit ka shqyrtuar shkaqet e ankimit dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk qëndrojnë dhe nuk duhen marrë parasysh prej saj dhe se nuk ka vend që të cenohet vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

18. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet nga kërkuari në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se aty janë parashtruar pretendimet e ngritura në rekurs nga ai, si dhe vlerësimi se gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin procedural, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa ka vlerësuar se pretendimet e tjera të tij lidheshin me çështje të vlerësimit të provave, çka del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së (*shih paragrafët 14-17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

19. Në rastin konkret, duke iu referuar arsytimit të gjykatave të zakonshme, Kolegji konstaton se kërkuari e ka ushtruar të drejtën e tij të paraqitjes së kërkesëpadisë, ku përmes një procesi gjyqësor, në të cilin janë përcaktuar faktet dhe është zbatuar ligji, është arritur në përfundimin se padia e tij duhet rrëzuar.

20. Gjithashtu, konstatohet se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, pasi ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, si dhe nuk ka pasur shkaqe të rënda procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit. Po kështu, lidhur me pretendimin e kërkuarit se Gjykata e Lartë është mjaftuar vetëm në shqyrtimin *de plano* të çështjes pa u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij, vlerësohet se arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nuk ka cenuar standardin kushtetues të arsytimit, në kushtet kur vendimi i kundërshtuar nga kërkuari plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e tij. Edhe pretendimi se Gjykata e Lartë duhet të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkuarit që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykatat e faktit i mohonte atij të drejtën e punës për sa u takon detyrimeve pozitive të punëdhënësit, ai nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të pretendimit të tij. Për rrjedhojë,

pretendimi i kërkuessit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

21. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuessit, bazuar në natyrën dhe përmbajtjen e tyre, konstatohet se, në thelb, ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe të fakteve, si dhe me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit. Si të tilla, ato nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuessit është haptazi i pabazuar.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuessit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.